



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 12 prill 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Mehmet Simnica, zyrtar i fushës, Fehmi Pireva – Zyrtar ndërlidhës për Agjencitë e Pavarura - Kuvend dhe Argzon Muçaj- Njësia për Standardizim e Kuvendit.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Besnik Osmani - ZAP, Artan Venhari - ZAP, Ibrahim Gylderren - ZAP, Albert Krasniqi - KDI, Blerta Bejtullahu - EUSR/EU Office dhe Sanije Berisha- OSBE.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.04.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit për Projektligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetari konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.04.2016

Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 06.04.2016, pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i Raportit për Projektligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se Projektligji Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e miratuara nga Komisioni Funkcional, më 23.03.2016, është proceduar në komisionet kryesore, të cilat për një kohë relativisht të shkurtër kohore kanë shqyrtuar Projektligjin bashkë me amendamentet e Komisionit Funkcional. Ku në rastin konkret del se amendamentet e KMFP-së për projektligjin nuk cenojnë dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, qoftë vendor, po ashtu edhe atij të Bashkimit Evropian.

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit KMFP ka arritur t'i nxjerrë 17 amendamente, të cilat tani janë në materialin e përgatitur nga administrata e Komisionit. Po ashtu, stafi i Komisionit ka pranuar raportet e komisioneve të përherëshme, të cilat nuk kanë dhënë vërejtje në amendamentet tona, dhe kanë konstatuar se nuk bien ndesh me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Megjithatë mendoj se aktualisht nuk është momenti që të aprovojmë raportin përfundimtar të projektligjit para se të shterën të gjitha diskutimet. Megjithatë, në ndërkohë, kemi marrë disa rekomandime nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe nga GIZ, të cilat shprehin shqetësimet, nëse mbetet që Zyrës Kombëtare të Auditimit(ZKA) t'i bëjë auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike. Megjithatë mendoj se nuk kemi kuadro aq profesionalë në këtë fushë, më tepër se sa vetë auditorët e ZKA. E padefinuar ka mbetur edhe paga e Auditorit të Përgjithshëm. Me këtë e hapi diskutimin.

Besnik Osmani, auditor i Përgjithshëm, theksoi se në përgjithësi jemi të kënaqur me propozimet e KMFP- së për Projektligjin Nr. 05/L-055 për auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, ne, kemi edhe disa propozime: Nuk mendoj se në projektligj të ceket me emër se cilat institucione duhet t'i auditojë ZKA, po ashtu me këtë projektligj nuk nënkupton themelimin e ZKA- së. Kjo nuk është diçka e re, është kontinuitet i ZAP- it që ka ekzistuar që sa vite dhe ka kryer auditime. Po ashtu raporti midis auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA- së nuk është definuar qartë edhe pse Kushtetuta thotë se do të krijohet një zyre, e cila do t'i asistojë auditorit të Përgjithshëm në kryerjen e detyrave, mendoj se me këtë projektligj nuk është definuar qartë. Po ashtu mendoje se secili institucion ka emblemën e vet, me këtë projektligj nuk është përcaktua se ZKA do ta ketë emblemën e vet. Projektligjit i mungojnë komplet atributet sanksionuese, ku mendoj se duhet t'i ketë secili projektligj. Po ashtu ka varshmëri të madhe buxhetore, ngjashëm me secilat organizata buxhetore. Kjo mendoj do ta pengojë ZKA- në në ushtrimin e detyrave të veta. E pa definuar ka mbetur edhe çështja e publikimit të raporteve të auditimit.

Xheladin Hoxha, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme, tha se amendamenti që ka të bëjë me auditimin e subjekteve politike, i propozuar nga Komisioni Funkcional, është në kundërshtim me

nenin 19 i Ligjit për Financimin e subjekteve politike. Po ashtu neni i cili ka të bëjë me përgatitjen profesionale të auditorit të Përgjithshëm, mendoj se është mirë të definohen qartë kriteret sa i përket përgatitjes profesionale të kandidatit. Po ashtu mendoj se në bazë të diskutimeve të bëra nga auditori i Përgjithshëm, projektligji duhet të kthehet në pikën zero, pra te sponsorizuesi.

Argzon Muçaj theksoi se amendamenti 10 i Komisionit Funkcional, për sa i përket raporteve financiare të subjekteve politike, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe as me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

Enis Spahiu, zyra ligjore MF, theksoi se nëse mendoni që Auditimi i Subjekteve Politike të bëhet nga ZKA- ja, atëherë duhet të keni parasysh se kjo mund të jetë në kundërshtim me nenin 37 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Unë propozoj që auditimi i Raporteve Financiare të Subjekteve Politike të rregullohet me Ligjin për Auditimin e Subjekteve Politike, në një mënyrë më ndryshe se deri tani. Po ashtu mendoj se edhe paga e auditorit të Përgjithshëm të rregullohet me Ligjin për Zyrtarët e Lartë Publikë.

Albert Krasniqi, KDI, sa i përket këtij projektligji dhe pjesës ku ka të bëjë me auditimin e Raporteve Financiare të subjekteve, mendoj se kjo duhet të rregullohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, e jo me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA.

Hajdar Beqa theksoi se Projektligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, është analizuar në KMFP disa herë dhe mendoj se vërejtjet e mia janë dhënë në amendamentet që i keni në materialin e bashkëngjitur, nga administrata e KMFP-së. Po ashtu mendoj se amendamenti 10 duhet të hiqet, që ka të bëjë me subjektet politike.

Fehmi Hyseni theksoi se tani Projektligji është në leximin e dytë në KMFP. Deputetët duhet ta dinë se nëse projektligji për AP dhe ZKA shkon në Seancë Plenare, atëherë KMFP nuk ka të drejtë të propozojë amendamente, edhe nëse projektligji kthehet në lexim të tretë në KMFP. Po ashtu mendoj se amendamenti i propozuar nga KMFP- ja për auditimin e Raporteve Financiare, është në kundërshtim me nenin 37 të Kushtetutës, si dhe amendamenti që ka të bëjë me shkarkimin e auditorit të përgjithshëm është i panevojshëm, sepse ZAP është kategori kushtetuese.

Hajdar Beqa theksoi se Kuvendi e zgjedh auditorin dhe mendoj se Kuvendi duhet ta shkarkojë, pra për këtë shkak ne kemi propozuar këtë amendament.

Enis Spahiu tha se Kushtetuta e ka rregulluar mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të auditorit të Përgjithshëm.

Argzon Muçaj theksoi se mënyrën e zgjedhjes, si dhe e shkarkimit është dhënë në Kushtetutë dhe kjo kompetence është e Kuvendit, e jo e Presidentit. Po ashtu edhe për subjektet politike duhet të auditohen nga ZKA- ja.

Fehmi Pireva tha se raportet financiare duhet të trajtohen njëjtë sikur këtë auditim ta bëjë ZKA, Kuvendi apo vetë KQZ-ja. Aktualisht mendoj se ZKA nuk do të duhet të këtë pengesë në auditimin e këtyre raporteve financiare.

Synavere Rysha mendon se Projektligji duhet të plotësohet me vërejtjet e fundit, si puna e sanksionimit apo suspendimit të Auditorit të Përgjithshëm, auditimit të subjekteve politike, për zgjedhja e zëvendësauditorit nga Kuvendi, si dhe Paga e Auditorit etj.

Naim Fetahu tha se ne, si Komision, kemi diskutuar kohë të gjatë Projektligjin për AP dhe ZKA, dhe sot kam pritur që të aprovojmë raportin përfundimtar. Megjithatë këtu po bisedojmë dhe po diskutojmë sikur KMFP të jetë në fillim të punës. Auditimi i raporteve financiare ishte temë për të cilin është kërkuar mendim i juristëve.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, theksoi se meqenëse po vërejmë se shumica prej deputetëve dhe të pranishmëve të tjerë po konsiderojnë se amendamenti 10 i KMFP-së është në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë këtë mund ta heqim. Po ashtu sa i përket nenit 19, paragrafi 4, të projektligjit në vend të fjalës Ministrin Përgjegjës, të zëvendësohet me fjalën Aksionarin. Ky propozim i jep mundësi që ZKA të bëjë auditimin e Ndërmarrjeve Publike që janë në kompetenca edhe të nivelit lokal. Te neni 16, paragrafi 1, drejtor i Përgjithshëm zëvendësohet me drejtor të Administratës. Po ashtu propozim për çështjen e pagës është që të mbetet si në propozimin që ishte në projektligjin e ZKA- së në legjislaturën e kaluar. Pra, paga e auditorit të Përgjithshëm të jetë ekuivalente me 90% të pagës dhe shtesës së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Këto amendamente u votuan nga shumica e deputetëve të pranishëm.

Përfundim

KMFP, miratoi 4 amendamente shtesë sa i përket: hiqet amendamenti 10 i KMFP-së që ka të bëjë me auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike, shtohet paragraf i ri me të cilin rregullohet Paga e Auditorit të Përgjithshëm, zëvendësohet fjala Ministrin Përgjegjës me fjalën Aksionarin, dhe që pozita drejtor i Përgjithshëm të zëvendësohet me pozitën drejtor i Administratës. KMFP, rekomandimet i dorëzon në Komisionet e Përhershme të Kuvendit.

3. Të ndryshme

Nuk pati diskutim në këtë pikë. Me këtë u mbyll takimi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetari i Komisionit

Ali Sadriu